



Në bazë të nenit 13.7, 14.7 lidhur me nenin 16.2 dhe të nenit 19.2 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullores nr. 2003/30, të dt. 10. 09.2003, nenit, 3 par. 1, pika b, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b dhe nenit 40, par. 3, pika II. të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 15.08.2005 merr

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PROPOZIMPLANIT RREGULLATIV PËR LAGJEN
“QENDRA 2” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Propozimplanit rregullativ për lagjen “Qendra 2” në Prishtinë.

Propozimplanit, nga par. 1 i këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërse të këtij Vendimi.

Neni 2

Propozimplanit, nga neni 1 i këtij Vendimi, duhet t`i nënshtrohet shqyrtimit publik.

Shqyrtimi publik i Propozimplanit rregullativ, sipas këtij Vendimi, zgjat 30 ditë, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Organizimin e shqyrtimit publik të Propozimplanit, sipas këtij Vendimi, do ta bëjë Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Neni 3

Pas përfundimit të shqyrtimit publik të Propozimplanit, nga neni 1 i këtij Vendimi, Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë, do të kryejë veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij Plani, në mënyrë që i njëjti t`i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve të Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 35-19427 dt. 19.08.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri